

Nr: 0201-234/6

07.02.2024

Shkup

PROCESVERBAL
nga seanca e 3-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 25.01.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional: Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Ognen Nedelkovski, Jeton Ismaili, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë : Ljupço Zlatev nga SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, Ilija Xhingoski, autorizues i SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup dhe Vasko Magleshov nga Prizma.

Z. Petrushevski hapi seancën e 3-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski shpjegoi se nëse Këshilli i paraqitet propozim për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, Ligji parasheh mundësinë që të ftohet transmetuesi për të dhënë arsyetim në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes. Meqenëse në seancë ishte i pranishëm përfaqësuesi i SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, i dha fjalën për deklaram.

Autorizuesi i Radio Hit FM Ilija Xhingoski shpjegoi se nga ana e Agjencisë kanë marrë njoftim se është ngritur procedurë për heqjen e lejes. Në pajtim me dispozitat ligjore, radioja

është dashur të paraqes katër të punësuar në radio, mirëpo llogaria e shoqërisë tregtare radiodifuzive Radio Hit FM SHPKNJP Shkup aktualisht është e bllokuar dhe po bëhen përpjekje për zhblokimin e saj. Ai ka thënë se në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, radioja duhet të paraqesë 4 të punësuar në marëdhënie të rregullt pune dhe për këtë janë bërë shpalljet për punësim, të cilat ai i ka për inspektim. Z. Xhingoski nga Këshilli kërkoi që të shtyhet procedura për 10 deri në 15 ditë për të përmbushur të gjitha kushtet e nevojshme, që nga 1 shkurti të fillojë me punë, të lajmërojnë personat në marëdhënie të rregullt pune dhe të zhblokohet llogaria e radios.

Z. Petrushevski shpjegoi se në këtë seancë Këshilli nuk merr vendim konkret nëse leja do t'i hiqet apo jo, kjo do të bëhet në seancën e 4-të që vijon pas përfundimit të kësaj. Ai theksoi se që prej hyrjes në fuqi të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ndryshimet në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, kjo është media e 5-të apo e 6-të që është renoncuar për shkak të mosplotësimit të kushteve minimale kadrovike. Ai tha se nuk do të komentojë atë vendim, por pasojat janë të dukshme për të gjithë. Me këtë rast, përfaqësuesi i Radio Hit FM nga Shkupi deklaroi se dëshiron të vazhdojë me punë edhe në të ardhmen, por tha se deri më tani Këshilli nuk ka pasur rast të tillë. Ai thekson se Këshilli është gjithmonë i kujdesshëm që të ketë qëndrim të njëjtë ndaj të gjitha mediave, duke respektuar në vazhdimësi Ligjin.

Z. Trajçev tha se transmetuesi ka dhënë argumentet e tij dhe ka kërkuar nga shërbimi profesional që të shpjegojë nëse ka ndonjë bazë ligjore për shtyrjen e procedurës?

Z. Trajçevski shpjegoi se deri më tani nuk ka pasur një rast të tillë. Informoi se Agjencia ka tentuar të komunikojë me radion që nga qershori i vitit 2023, por nga ana e tyre nuk ka pasur asnjë sinjal kthyes. Ai iu drejtua përfaqësuesit të radios dhe i tha se të gjitha këto që kishte paraqitur në seancë mund t'i bënte para 15 ditësh, kur morën njoftimin për iniciimin e procedurës. Në lidhje me shtyrjen e procedurës, ai shpjegoi se teorikisht janë dy opsione. E para është që Këshilli të miraton vendim për heqjen e lejes, radio më pas do të ndërpresë transmetimin, ndërkohë do të punësojë personat e nevojshëm dhe me padi në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh do të kërkojë që leja t'i kthehet. Këtë opsion në të kaluarën është përdorur nga disa transmetues kur u është hequr leja për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore. Opsioni i dytë është që Këshilli të miraton vendim për ndërprerjen e procedurës, por fillimisht duhet të dorëzohen dokumentet zyrtarisht për të parë se është ashtu siç tha përfaqësuesi, që Këshilli t'i shqyrtojë dhe më pas të vendosë. Gjithashtu, në kërkesën për shtyrje të procedurës duhet kërkuar një afat konkret deri kur mendojnë se duhet shtyrë për të plotësuar kërkesat minimale kadrovike.

Z. Petrushevski kërkoi përgjigje nga shërbimi, a ka mundësi ligjore që të shtyhet procedura dhe për sa ditë, në mënyrë që Këshilli të miraton vendim?

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se Ligji parasheh që Këshilli do të marrë vendim në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit. Propozimi është pranuar më 12 janar dhe afati skadon më 27 janar 2024, ditën e shtunë, e cila kalohet në ditën e ardhshme të punës, pra të hënën. Deri atëherë procedura mund të shtyhet dhe pastaj Këshilli duhet të miraton vendim.

Z. Petrushevski tha se jozyrtarisht do të propozojë që vendimi i Këshillit për procedurën e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të jetë deri të hënën, më 29 janar 2024.

Z. Trajçevski shtoi se avokati i radios duhet paraprakisht të gjitha ato që tha në seancë, t'i dorëzojë si dokumente përmes arkivës ose në e-mail adresën zyrtare të Agjencisë dhe Këshilli të hënën të deklarohet.

Z. Trajçevski tha se do të japë një shpjegim. Ai ka thënë se personat mund të paraqiten si të punësuar të radios pavarësisht nga llogaria e bllokuar e shoqërisë tregtare radiodifuzive, gjegjësisht kjo nuk paraqet pengesë për punësime të reja. Nëse personat nuk lajmërohen të hënën, atëherë Këshilli do të duhet të heqë lejen. Më pas radioja do të duhet të shkojë me padi në Gjykatën Administrative për t'i rikthyer lejen. Ai theksoi se më së voni të hënën duhet të lajmërohen 4 persona si të punësuar dhe kjo në mënyrë të rregullt të dorëzohet në Agjenci dhe Këshill, në mënyrë që të mos i hiqet leja.

Z. Fidanoski tha se pajtohet me qëndrimin e z. Trajçev, gjegjësisht se veprimi i Këshillit mund të shtyhet deri të hënën, por nëse është e mundur që sot përfaqësuesi i transmetuesit t'i dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme që ai tha gojarisht në diskutim para Këshillit, në mënyrë që t'i shqyrtohen në kohën e duhur.

Z. Petrushevski paralajmëroi se do ta shtyjë pikën për të hënën.

Pika 2

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,**

d.v.